



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Shkurt 2026

Data 24.02.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dities:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.01.2026 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z.Elton Bepin Frashnaj.
- 3.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2026.
- 4.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.74 datë 23.12.2025 "Miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës".
- 5.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.73 datë 23.12.2025"Miratimin e nivelit të pagave për funksionaret e zgjedhur e të emëruar,nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026".
- 6.Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj..Mrike Doda në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.
- 7.Projekt vendim për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përlitimit për Znj.Tone Pjetraj në programin e strehimit "Subvencionit të qirasë në tregun e lirë".
- 8.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 24.02.2026 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 21 këshilltarë,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda Ndreca,Leonora Prenga,Rita Preçi,Elton Frashnaj,Gjon Marku,Florin Tanushi,Rregjinë Shelqetja,Ermir Tahiri,Kastriot Shkjau,Vjollcë Zagani,Edona Molla,Mirela Vasija,Besmir Kapaj,Ferdinad Fusha,Mark Bisha,Sanije Salja,Pjeter Lleshi) korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dities dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e dities.Në këtë moment largohen nga mbledhja Z.Ferdinand Fusha dhe Z.Pjeter Lleshi ku ky i fundit paraqiti si arsye largimi një rast



vdekje në rrethin familjarë.Mbeten prezent 19 këshilltarë.Po në këtë moment bëhet pjesë e mbledhjes edhe Z.Marin Dodaj,dhe pjesmarrja e këshilltarëve në mbledhje bëhet 20 këshilltarë korum i mjaftueshem për zhvillimin e mbledhjes.Rendi i ditës u miratua me 19 vota Pro. Këshilltarët që votuan pro(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda Ndreca,Leonora Prenga,Rita Preçi,Gjon Marku,Florin Tanushi,Rregjinë Shelqetja,Ermir Tahiri,Kastriot Shkjau,Vjollcë Zagani,Edona Molla,Mirela Vasija,Besmir Kapaj, Mark Bisha,Sanije Salja, Marin Dodaj)Z.Elton Frashnaj nuk ka të drejtë vote deri në momentin pasi të bëjnë betimin.

### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.01.2026 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

Z.Ardian Çelepija-sekretar i K.B, sqaron këshilltarët lidhur me vendimmarrjet e muajit Janar 2026 dhe konkretisht për Vkb nr.7 i cili është kthyer për plotësim nga Institucioni i Prefektit Qarkut Skodër ku kerkohet më i detajuar plani paraprak i mbarështimit në ekonominë pyjore Gjader Mnelë, plotësim i cili është bërë dhe i është dërguar zyrtarisht Institucionit të Prefektit Qarkut Skodër, si dhe Vkb nr.10 i cili është miratuar nga Institucioni i Prefektit Qarkut Skodër por për dy familje të përmbytura kërkohe saktësim dokumentacioni, konkretisht për Z.Ernest Paluku kërkohe të ndahet dëmi i shkaktuar nga përmbytjet mes biznesit dhe banesës si dhe për Znj Mrikë Leka ku kërkohe të saktësohe procesverbali i konstatimit me procesverbalin e vlerësimit të dëmit, gjë e cila është plotësuar dhe i është dërguar zyrtarisht Institucionit të Prefektit Qarkut Skodër informacioni i kërkuar.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 29.01.2026 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda Ndreca,Leonora Prenga,Rita Preçi,Gjon Marku,Florin Tanushi,Rregjinë Shelqetja,Ermir Tahiri,Kastriot Shkjau,Vjollcë Zagani,Edona Molla,Mirela Vasija,Besmir Kapaj, Mark Bisha,Sanije Salja, Marin Dodaj) Z.Elton Frashnaj nuk ka të drejtë vote deri në momentin pasi të bëjnë betimin.

### **Z.Ervis Shimaj lexon piken 2 të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z.Elton Bepin Frashnaj.

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se janë ndjekur procedurat ligjore për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z.Elton Bepin Frashnaj si pasoje e vakances së krijuar nga Z.Aleko Dodani dhe se nga KQZ Tiranë ka ardhur vendimi për vazhdimin e procedurave për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z.Elton Bepin Frashnaj, si dhe komisioni i mandateve ka propozuar miratimin e tij.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë ndonjë gjë për diskutim, këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime dhe projekt vendimi hidhet në votim Miratohet me 19 vota Pro, zero kundër, zero abstenim këshilltarët që votuar Pro(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda



Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Gjon Marku, Florin Tanushi, Rregjinë Shelqetja, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Vjollcë Zagani, Edona Molla, Mirela Vasija, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Marin Dodaj) Z.Elton Frashnaj nuk ka të drejtë vote për mandatin e tij.

Z.Ervis Shimaj lexon formulën e betimit dhe Z.Elton Frashnaj Betohet, dhe numri i këshilltarëve me të drejtë vote bëhet 20.

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken 3 të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2026.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyles se ndihmes ekonomike,e cila relatton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Janar 2026, 127 familje, me 398,942 lekë, me 5.98 % e fondit total.Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Janar 2026 janë shpallur fitues, 861 familje, me fond 6,656,296lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 399,377 lekë.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim. Z.Gjon Marku nuk merr pjesë në votim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 3 të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda Ndreca,Leonora Prenga,Rita Preçi,Florin Tanushi,Rregjinë Shelqetja,Ermir Tahiri,Kastriot Shkjau,Vjollcë Zagani,Edona Molla,Mirela Vasija,Besmir Kapaj, Mark Bisha,Sanije Salja, Marin Dodaj,Elton Frashnaj)

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken 4 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.74 datë 23.12.2025 "Miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Armena Zagani-përgjegjëse e zyles financë buxhatit Bashkia Vau Dejës e cila spjegon se ndryshimet qe propozohen jane te gjitha ne rritje te zerave te investimeve qe janë pjesë e projekteve prioritare për vitet 2026-2028, dhe ne pakesim te zerave qe nuk jane pjese e projekteve prioritare për vitet 2026-2028.Në zbritje do te preken zera te trashëguar nga vitet e kaluara, kryesisht mbetje te akumulara ne vite, dhe qe jane realizuar pjesesisht si shpenzim, dhe nuk kane me arsye te jene pjese e buxhetit me ato vlera.Pra keto veprime jane te mundura ne kete moment, me realizimin e trashëgimit te fondeve buxhetore dhe cash nga viti 2025.Po ashtu duke u nisur nga shkresa Nr 878 Prot datë 12.02.2026 e Drejtorisë së Menaxhimit të Pyjeve, Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit drejtuar Sektorit të Buxhetit dhe Financës me lëndë "Kërkesë për hartim plane Mbarështimi të Pyjeve dhe Kullotave" jemi angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projektit duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore për diferencën e vlerës së padisponueshme aktualisht në këtë program për këtë zë investimi.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, një votë abstenim.( Z.Gjon Marku) .**Këshilltarët që votuan pro piken e 4 të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda Ndreca,Leonora Prenga,Rita



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Preçi, Florin Tanushi, Rregjinë Shelqetja, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Vjollcë Zagani, Edona Molla, Mirela Vasija, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Marin Dodaj, Elton Frashnaj

Z. Ervis Shimaj lexon piken 5 të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.73 datë 23.12.2025 "Miratimin e nivelit të pagave për funksionaret e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026".

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Armena Zagani-përgjegjëse e zyrës financë buxhatit Bashkia Vau Dejës e cila spjegon se propozohet ndryshimi i nivelit të pagave për punonjësit e Administratës së Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026, konkretisht për punonjësit e shërbimeve ku është bërë ndryshimi i pagës minimale sipas VKM-së, i punonjësve mbështetës si dhe disa drejtuesve kjo bazuar në ngarkesën e punës.

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.

Z. Frano Prenga pyet: Kjo vlerë e rritjes së pagave si do mbulohet?

Znj. Armena Zagani përgjigjet se kjo vlerë mbulohet nga transfertat e Ministrisë dhe nga të ardhurat.

Z. Gjon Marku pyet: Rritja e pagave a është bërë maksimale?

Znj. Armena Zagani përgjigjet se për punonjësit mbështetës është rritje minimale ndërsa për pjesën tjetër është bërë rritje sipas mundësisë.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro, 1 votë kundra (Z. Gjon Marku), zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 5 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Meliha Zyberaj, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Florin Tanushi, Rregjinë Shelqetja, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Vjollcë Zagani, Edona Molla, Mirela Vasija, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Marin Dodaj, Elton Frashnaj)

Z. Ervis Shimaj lexon piken 6 të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuara Znj. Mrike Doda në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Marketa Lleshaj-specialiste e zyrës strehimit social, Bashkia Vau Dejës e cila spjegon se mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës të zj. Mrike Doda për sistemimin e saj në qendrën për të moshuar "BESA" Barbullush, ju paraqesim propozimin tonë për miratim. Zj. Mrike Doda është shprehur jeton vetem në një banesë me qira dhe perballat me vështirësi në permbushjen e nevojave të përditshme. E moshuara Mrike Doda, paraqet kërkesë për akomodim në shërbim rezidencial (azil), për shkak të mungesës së mbështetjes familjare të vazhdueshme dhe pamundësisë për vetë-kujdes. Duke marrë parasysh moshën gjendjen shëndetsore, vetminë dhe mungesën e kujdesit familjar, propozohet akomodimi i tij në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush" ku do



mund të marre perkujdesjen e nevojshme, sherbimet baze të jetetses, ndihmen mjeksore dhe mbeshtetje sociale të vazhdueshme.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 20 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 6 të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda Ndreca,Leonora Prenga,Rita Preçi,Florin Tanushi,Rregjinë Shelqetja,Ermir Tahiri,Kastriot Shkjau,Vjollcë Zagani,Edona Molla,Mirela Vasija,Besmir Kapaj, Mark Bisha,Sanije Salja, Marin Dodaj,Elton Frashnaj,Gjon Marku)

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken 7 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e vazhdimësisë dhe vleren e përfitimit për Znj.Tone Pjetraj në programin e strehimit "Subvencionit të qirasë në tregun e lirë".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Dajana Lleshi-pergjegjese sektorit strehimit social, Bashkia Vau Dejës e cila spjegon se Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.57 dt.27.10.2025, "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 me 26.03.2025, VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit", realizoi mbledhjen në datën 16.02.2026. Ku u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë dhe kontrataes së qirasë noteriale për banorën Tone Pjetraj.Nga vlersimi social ekonomik vërehet se kjo banore është e pastreh jeton e vetme, pa të ardhura vetem me ndihmë ekonomike dhe si rrjedhoje nuk mund të perballoje një shtëpi me qira. si dhe shpenzimet jetike.Komisioni i strehimit e shikoj të arsyeshme për asisituat si përfitues të programit të strehimit subvencionit i qirasë në tregun e lire.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim, Z.Gjon Marku nuk merr pjesë në votim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 7 të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola,Meliha Zyberaj,Majlinda Ndreca,Leonora Prenga,Rita Preçi,Florin Tanushi,Rregjinë Shelqetja,Ermir Tahiri,Kastriot Shkjau,Vjollcë Zagani,Edona Molla,Mirela Vasija,Besmir Kapaj, Mark Bisha,Sanije Salja, Marin Dodaj,Elton Frashnaj)

#### **Pika 8:Të ndryshme.**

Z.Gjon Marku ngre shqetësimet si më poshtë:

- 1.Të ndërhyhet në rrjetin ndriçues të qytetit Laç Vau Dejës sepse vërehet se nuk funksionon i rregullt.
- 2.Kërkoj që të bëhet rrethimi i shkollës në qytetit Laç Vau Dejës sepse rrethimi aktual eshte prishur
- 3.Kërkoj që të ndërhyhet në rrugen e Dushajve sepse ka nevojë për sistemim.
- 4.Kërkoj rregullimin e rruges së varrezave dhe rrethimin e tyre.

Z.Elvis Preçi-Zv.Kryetar Bashkie premtion se këto shqetësime të ngritura do të shikohen me përparësi.Në këtë moment bëhen pjesë për firmosje protokolli Dy këshilltarët e larguar në fillim të mbledhjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit, mbledhja e Kshillit Bashkiak e datës 24.02.2026

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian



Këshilltarët:

- |                              |                            |
|------------------------------|----------------------------|
| 1. <u>Ervis Shimuq</u>       | 17. <u>Mirela Vesija</u>   |
| 2. <u>frano Prunpa</u>       | 18. <u>Besmir Kary</u>     |
| 3. <u>Frangje Kola</u>       | 19. <u>Ferdinand Juska</u> |
| 4. <u>Melike Zheret</u>      | 20. <u>Ilir Bisha</u>      |
| 5. <u>Mojlinda Mkeca</u>     | 21. <u>Samir Selge</u>     |
| 6. <u>Leonora Prunpa</u>     | 22. <u>Novina Basha</u>    |
| 7. <u>Rita Bregu</u>         | 23. _____                  |
| 8. <u>Elton Jorgji</u>       | 24. _____                  |
| 9. <u>Erion Prunpa</u>       | 25. _____                  |
| 10. <u>Honor Prunpa</u>      | 26. _____                  |
| 11. <u>Regjine Shelqetja</u> | 27. _____                  |
| 12. <u>Emir Tahiri</u>       | 28. _____                  |
| 13. <u>Mastriot Shkiper</u>  | 29. _____                  |
| 14. <u>Ngjelle Zogari</u>    | 30. _____                  |
| 15. <u>Edona Molla</u>       | 31. _____                  |